



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

V E N D I M  
Nr. 328, datë 29.12.2016

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES SË  
ZËVENDËSPROKURORIT TË PËRGJITHSHËM TË PROKURORISË SË  
PËRGJITHSHME”**

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “dh” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 39 pika 6 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”,

**V E N D O S A:**

1. Miratimin e rregullave për procedurën e zgjedhjes së Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm, si vijon:
  - a) Zëvendësprokurori i Përgjithshëm zgjidhet nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme që plotësojnë kriteret e parashikuara nga ligji;
  - b) Drejtori i Kabinetit në bashkëpunim me specialistin e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, përgatisin një relacion me emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore;
  - c) Prokurori i Përgjithshëm thërret Mbledhjen e Prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme për të marrë mendimin e saj. Data, vendi dhe rendi i ditës u njoftohet prokurorëve të paktën tre ditë përpara zhvillimit të mbledhjes dhe shoqërohet nga relacioni përkatës;
  - ç) Mbledhja hapet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe me kërkesë të çdo prokurori mund të diskutohet mbi kandidaturat. Në përfundim të diskutimeve secili prokuror jep mendim nëpërmjet votimit të hapur për çdo kandidaturë. Kandidatura që ka marrë numrin më të madh të votave konsiderohet si i rekomanduar nga Mbledhja e Prokurorëve;

- d) Për mbledhjen mbahet procesverbal i përmbledhur.
2. Prokurori i Përgjithshëm zgjedh Zëvendësprokurorin e Përgjithshëm, në përputhje me nenin 39 të ligjit 97/2016 dhe këtë vendim. Mendimi i mbledhjes së prokurorëve nuk është i detyrueshëm për Prokurorin e Përgjithshëm.
  3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtori i Kabinetit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**ADRIATIK LLALLA**

